



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 230, dt.14.09.2016

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren e miratuar me vendim të KKR nr. 75, dt.03.04.2015, “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licencave të ushtrimit të profesionit të restauratorit” në mbledhjen e datës 14.09.2016, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, pasi shqyrtoi kërkesën për heqje të licensës së restaurimit të dhënë shoqërisë “MET –ENGINEERING” sh.p.k, për shkak të paraqitjes së dorëheqjes së drejtuesit teknik restaurator *ing. Fatjon Saliu* nga kjo shoqëri, si dhe shqyrtimit të kërkesës për dhënie license të shoqërisë “AGI-KONS” sh.p.k me drejtues teknik restaurator z. *Fatjon Saliu*, (R.P.58).

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën për heqjen e licensës së shoqërisë “MET –ENGINEERING” sh.p.k, për shkak të mbetjes pa drejtues teknik restaurator.
2. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “AGI-KONS” sh.p.k, me drejtues ligjor z.Alban Çinari për pajisje me licencë restaurimi për kategorinë: CZ: “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi” me drejtues teknik restaurator **ing. Fatjon Saliu**.
3. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, miratimin e kërkesës për pajisje me licencë restaurimi për shoqërinë “AGI-KONS” sh.p.k, për kategorinë: CZ: “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi” me drejtues teknik restaurator **ing. Fatjon Saliu**.
4. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI